

Formula e suksesit = 1% frymëzim dhe imagjinatë + 99% punë dhe angazhim. Inspirimi dhe imagjinata nuk përbëjnë vetëm se 1% e suksesit, derisa përpjekja dhe mudi janë rruga e vërtetë e tij. në fakt, janë 9/10 –tat e suksesit.

- 1) Le të jetë qëllimi yt vetëm për Allahun. Kërkimin e dijes shndërroje në adhurim.
- 2) Përkujto gjithnjë se bekimi për suksese është prej Allahut ndërsa puna (shkaqet) duhet të jenë prej teje.
- 3) Fshije nga fjalori dhe jeta jote fjalën 'do të'!
- 4) Ke kujdes nga inspirimet negative: unë jam dështak, lënda është e vështirë, nuk mësohet dot, etj.
- 5) Lidhu për besimit tënd në Allahun, dije se pa bekimin e Tij nuk mund të korrësh sukses, por mëso, ngase kjo kërkohet prej teje!
- 6) Bindu për rëndësinë e diturisë dhe të mësuarit.
- 7) Ke kujdes shokët e këqij dhe ata që ta mbysin kohën!
- 8) Rregullo librat tua dhe renditi ato, ngase kjo ndikon më shumë në freskimin e memories sate.
- 9) Kryej detyrat tua menjëherë, mos i lërë për më vonë.
- 10) Kujdes ushqimet e shpejta (fast food). Ha ushqime të freskëta, si: pemë, perime, etj.
- 11) Koordino kohën tënde. Mos i përsërit mësimet kur je shumë i lodhur.
- 12) Përkujto se mënyra më e mirë e shfrytëzimit të kohës është të fillosh tani, pa humbur as edhe një çast.
- 13) Përcaktoi prioritet e mësimit dhe studimit sipas kohës në dispozicion.
- 14) Përpilo një tabelë ditore dhe javore për kohën tënde dhe mësimet, që duhet dhënë prioritet.

Përshtati në shqip: [Sedat ISLAMI](#)